

AKT-THEMELIM DHE STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ALERA Sh.p.k

Neni 1

THEMELIMI I SHOQËRISË

Sot më dt. 08 Korrik 2024, bazuar në kërkesat e Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), Ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Rregullorja 31/2007 "Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor" me vullnetin tim të lirë (sot e në vazhdim Ortak Themelues), unë, Egzon Berisha me atesi Blerim, amesi Xheva ; i datelindjes 08.07.1999, lindur ne Sllatine e Madhe Kosove, dhe banues ne Lezhe, Lagjia Beslidhja, me ID personale numer 1248379487 dhe leternjoftim elektronik me nr ID1991836; vendosa të krijoj Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **ALERA Sh.p.k.**

Aktiviteti bazë i kësaj shoqërie rregullohet me anë të këtij Statuti.

Shoqëria vepron në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar) , me ligjin 9723 datë 03.05.2007, për Qëndrën Kombëtare të Biznesit, (të ndryshuar) , Ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Rregullorja 31/2007 "Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor" e të tjera ligje në fuqi të legjislacionit shqipëtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj ku do të shkruhet emëri tregtar dhe nipti.

Neni 2

EMËRTIMI

Emërtimi tregtar është **ALERA Sh.p.k**

Neni 3

SELIA

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën; Lezhe, Njesia Vendore Shenkoll, banese private katë pare zona kadastrale Nr 1879, Numer Pasurise 37/46
Shoqëria **ALERA Sh.p.k** ka të drejtë të hapë zyra, përfaqësi e filiale në rrethe të tjera të vëndit dhe jashtë Shqiperisë.

Neni 4

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë **ALERA Sh.p.k** është pa afat.

Egzon Berisha

Egzon

Afatí mund tē caktohet ndryshe, apo tē vihet nē likujdim, vetëm me vëndim tē Asamblesë së Përgjithshme te Ortakëve, ose i është Ortakut tē Vetëm.

Neni 5

PËRGJEGJËSITË

Shoqëria nuk përgjigjet pér detyrimet e marra pér qëllime që nuk përputhen me ato tē përcaktuara nga Statuti. Shoqëria nuk përgjigjet pér detyrimet e marra nga ortakët ne emërin e tij personal ndaj personave tē tretë.

Neni 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimitarisë ekonomike i shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar **ALERA Sh.p.k** është:

Agjent i shit-bierjes te pasurive patundshme; Veprimi investimi ne fushen e Turizmit e ndertimit ; si dhe edo aktivitet tjetër tē lejuar me ligj.

Neni 7

KAPITALI I SHOQËRISË

Vlera e përgjithshme e kapitalit tē rregjistruar si Kapital Themeltar Filletar i Shoqërisë **ALERA Sh.p.k** Kapitali themeltar filletar i shoqërisë është **500 000 Lekë** (pësëqindmijë) . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre tē mëposhtme: me Ortakë Themelues:

1. **Egzon Berisha**, zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë tē përgjithshme = 500 000 Lekë ; që përbën 100% e kapitalit themeltar tē shoqërisë.

Neni 8

TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT

1. Në rastin e transferimit tē kuotave tē kapitalit, ortaku që kërkon tē shesë kuotat e tij tē kapitalit duhet tē njostojë me shkrim administratorin , i cili njofton menjëherë Asamblenë e Përgjithshme tē Ortakëve pér cmimin e shitjes së kuotave nga ortaku që kërkon ti shesë.
2. Cmimi i kuotave, oferte pér shitje duhet tē vendoset ne baze tē vlerës reale tē shoqërisë në momentin e dhëniec së tē drejtës. Ortakët e tjerë mund ti blejnë në raport me kuotat ekzistuese, duke ruajtur tē njëjtat raporte me kuotat që posedon sejciili.
3. Në qoftë se brenda 30 ditëve nga komunikimi i ofertës pér shitje tē kuotave tē kapitalit tē shoqërisë, asnjeri nga ortakët e shoqërisë nuk shprechet pér blerjen e tyre, atëherë, kuotat ofertë shitje, mund ti transferohen edo personi që kërkon ti blejë.

Egzon Berisha
Egzon

Neni 9

TRANSFERIMI TEK PJESTARË I FAMILJES

Pjesët e kapitalit janë ligjërisht të transferueshme mes bashkëshortëve, si dhe mes paraardhësve dhe pasardhësve. Transferimi i pjesës së kapitalit mes bashkëshortësh, në rast ndarjeje pasurie gjithashtu nuk kufizohet.

Neni 10

TRANSFERIMI I KAPITALIT NË RRUGË TRASHËGIMIE OSE FALIMENTIMI

1. Në rast se një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët ne rastin e bashkëzotërimit të kuotave me trashëgimtarët e tij, në rast se ky person ishte zotëruesh ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesh të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gjëzues i të drejtave mbi kuotën e tij. Pavarësisht parashikimeve të ketij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk cilohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjera.
2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara, administratori mund të zgjedh të bëhet zotëruesh i kuotës ose të kërkojë rregjistrimin e kuotave në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësiperzgjedh të bëhet zotëruesh i kuotës ai njofton shoqërine në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të rregjistrohet si zotëruesh i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
3. Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, do të ketë të drejtat që gjëzonte zotërueshi kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesmarries ose të votës në edo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve deri në momentin e rregjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

FORMA E TRANSFERIMIT TË PJESËVE TË KAPITALIT

1. Kontrata për transferimin e pjesës së kapitalit duhet të jetë në formën e aktit notarial, dhe, në rast se pronari i ri nuk është ortak i shoqërisë, duhet të deklarojë shprehimisht në kontratë se është njohur me Aktin e themelimit të shoqërisë dhe Statutin e shoqërisë dhe se është dakord me to. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.
2. Administratori, mund të refuzojë rregjistrimin e kalimit të kuotës në QKB, në rast se kjo kuotë nuk është shillyer plotësisht ose në rast se Administratori, nuk është dakord me personin të cilit i kalon kuota.

Ergon Berisha
Ergon Berisha

3. Nëse administratori, apo administratorët refuzojnë të rregjistrojnë kalimin e kuotës, ata njoftojnë për mospranimin e personit të cilët i kalon kuota, brënda një muaji nga dita në të cilën është paraqitur në shoqër kërkesa për rregjistrimin e kalimit të kuotës.

Neni 12

ZMADHIMI I KAPITALIT

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të rrisë pa kufi kapitalin shoqërisë, në çdo moment, dhe një ose disa herë, me votim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve votues prezent apo përfaqësues sipas ligjit. Mbës miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, vëndos për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë, që, këto fitime të zmadhojnë kapitalin e rregjistruar, të rrisë rezervat statutore ose të shpërndajë divident.

Në asnjë rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë, pa mbuluar më parë humbjet e trashëguara në pasqyrat financiare. Në të gjitha rastet ndryshimet në kapital pasqyrohen në pjesët e ortakëve në mënyrë proporcionale që janë deklaruar.

Në përputhje në nenin 77 te ligjit nr. 9901, para se të vëndoset shpërndarja e dividentit, administratori lëshon certifikatë të aftësisë paguese. Kjo certifikatë lëshohet, vetëm nëse pas pagimit të dividentit, aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe se shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori njofton për rregjistrim në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 13

KRIJIMI I RREZERVAVE

Mbas miratimit të pasqyrave financiare, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve krijon rrezerva statutore. Rrezerva statu ore duhet të jetë per cdo vit jo më pak se 10% e fitimit vjetor. Kur këto rrezerva të kapin shumën e 10% të kapitalit themeltar mund të mos krijojë më rrezerva.

Neni 14

ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

1. Kapitali themeltar mund të zvogëlohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
2. Në cdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e percaktuar me ligj.
3. Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë përballohet nga secili ortak në mënyrë proporcionale sipas kuotave që zotërojnë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë brenda limiteve të ligjit, qoftë edhe nëpërmjet ortakut të vetëm, apo grupe ortakësh, aktivitelesh të shoqërisë apo aksioneve ose kuotave të shoqërive të tjera në të cilat shoqëria bën pjesë.



4. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit njostohet për rregjistrim në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet Administratorit

Neni 15

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
2. Administratori.

Neni 16

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Organ i vëndimor i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar **ALERA SH.P.K** është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Vëndimet e saj me shumicë pengojnë ortakët që mungojnë apo të papajtueshëm , përvèc rasteve të së drejtës së tyre të kundërshtimit të ushtruar në raste, afate apo forma të parashikuara në ligj.

Gjatë kohës që shoqëria do të ketë një ortak të vetëm, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm. Të gjitha vëndimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve apo Ortaku i Vetëm rregistrohen në rregjistrin e vëndimeve, të dhënat e të cilat nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Asambleja është organi më i lartë vëndimor i shoqërisë i cili , e cila, është përgjegjëse përmarrjen e vëndimeve për shoqerinë lidhur me cështjet e aktivitetit të shoqërisë dhe vëndos për:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- Ndryshimin e statutit.
- Emërimin dhe largimin e administratorit
- Emërimin dhe largimin e likuiduesve dhe ekspertit kontabël të autorizuar.
- Përcaktimin e shpërblimeve për personat e emëruar likujdorë, ekspert, përsaquesues në gjykatë etj.
- Miratin e bilancit vjetor, ndarjen e fitimit dhe mënyrën e ndarjes së humbjeve të shoqërisë.
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar.
- Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
- Riorganizimin dhe Prishjen e shoqërisë.
- Çështje të tjera te parashikuara me ligj, të cilat ky statut i lë në kompetencë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 17

MBLEDHJA E ASAMBLESË DHE VOTIMI


Egzon Berisha
Edhem

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901 dt. 14.04.2008, në rastet e parashikuara në statut dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë ne vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e percaktuar sipas Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërise nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë ose të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertefikuara.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlere më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertefikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij nenit, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij nenit nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij nenit, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri ne 5, të këtij nenit, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.
9. Vendinot në mbledhjen e asambleve ose pas konsultimit me shkrim merren nga një ose disa ortakë që përfshiqësojnë më shumë se tre të katërtat e kapitalit themeltar. Ky numër votash mjafton edhe për ndryshimin e statutit te shoqërisë.
10. Të gjitha vëndimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, rregistrohen në proces verbal dhe administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e kopjove të tyre.

Neni 18

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

1. Ortaku ka të drejtë të informohet lidhur me administrimin e shoqërisë, të njihen me bilancin vjetor dhe të lërkohjë me shkrim sqarime të cilat i jep administratori i mbledhjes së asamblesë.
2. Secili nga ortakët ka të drejte t'i kerkojë gjykatës që të heqë nga funksioni administratorin i cili ka shkelur ligjin.



3. Secili r ga ortakët ka të drejte t'i paraqesë me shkrim dy herë në vit administratorit pyetje lidhur me problemet, egzistenca e të cilëve vë në dyshim vazhdimësinë e aktivitetit të shoqerisë. Lidhur me përgjigjen e administratorit vihen në dijeni edhe Eksperti Kontabël i Autorizuar.
4. Në rast se shoqëria nuk ka Ekspert Kontabël të Autorizuar, atëherë emërtimi i një eksperti kontabël të autorizuar mund te kërkohet në rrugë gjyqësore nga një ose disa ortakë, pjesët e kapitalit të të cilëve perfaqësojne të paktën 5% e kapitalit themeltar.
5. Një nga disa ortakë, pjesa e kapitalit të të cilëve së bashku perfaqesojnë 5% e kapitalit themeltar, mund të kerkojnë në rrugë gjyqësore caktimin e një ose disa ekspertëve të ngarkuar për paraqitjen e një raporti për një apo disa veprimtari administrative. Raporti i ekspertit i dorëzohet ortakut/ortakëve që ka bërë kérkesën, administratorit, eventualisht ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se janë emëruar, raporti paraqitet në mbledhjen e ardhshme të asamblesë.
6. Ortaku nuk mund të marrë hua nga shoqëria, të mimratojë në emër të shoqërisë paradhënet ose të bëhet garant për detyrimet ndaj personave të tretë. Në rast të kundërt veprimi është i pavlefshëm, kjo vlen edhe për përfaqesuesit ligjorë të tij, bashkëshortin si dhe pasëardhësit e tij.
7. Ortaku që është person juridik, është i detyruar që menjëherë të njoftojë ortakët e tjera lidhur me ndryshimet e statutit ose të përbërjes së organeve te shoqërise së tij.
8. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
9. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqesues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

NENI 19

ADMINISTRATORI

Shoqëria përfaqësohet nga administratori.


Në emër të shoqërisë firmos administratori i cili bashkëngjit emërtimin tregtar të shoqërise, emërin e mbiemërin dhe funksionin e tij.

NENI 20

EMËRIMI I ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqërisë **ALERA Sh.p.k** do të jetë një ose më shumë persona që emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicën e zakonshme të votave të ortakëve ose Ortakut të Vetëm. Administratori emërohet për një afat pesë vjear më të drejte persëritje

Administratori i shoqërisë do të jetë z. **Egzon Berisha** datelindjes 08.07.1999, idendifikuar me kartë identiteti ID personale numer 1248379487, per një afat 5 vjear me të drejte persëritje.



Administratori mund të jetë ortak në shoqëri ose jo.

Asambleja e Përgjithshme Ortakëve mund të shkarkojet atë në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

NENI 21

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori ka të drejtë të veproje në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me persona të tretë personale i perket të gjitha çështjëve me perjashtim të atyre që ligji ose ky statut i lë në kompetencë të asamblesë.
2. Administratori ka për detyrë në kuadrin e kompetencave të tij të sigurojë mbajtjen e rregullt të evidencës dhe llogarisë sipas ligjit, të mbaje listën e të gjithe ortakëve dhe të informojë ortakët lidhur me çështjet që i takojnë shoqërisë.
3. Përgadit dhe nënshkruan bilancin vjetor dhe raportet për sezonin e shoqërisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet para asamblesë së përgjithshme përmiratim;
4. Paralajmëron në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimit tarisë dhe ekzistencën e shoqërisë ;
5. Kryen rregjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë , sic parashikohet në ligjin përmiratim; Qëndrën Kombëtare të Biznesit;
6. Raporton përpëra Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe në realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimit tarisë e shoqërisë.
7. Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:
 - Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiviteti e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.
 - Kur kerkohet shitja apo disponimi i aktiveve në një mënyrë tjetër me një vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë të vlerësuara në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
8. Administratori ka për detyrë të përcaktojë stafin drejtues dhe të pajtojë punëmarrës në shoqëri në funksionet që ai i sheh të arësyeshme .
9. Nënshkruan kontratat e punës me punëmarrësit.
10. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ketë statut.

NENI 22

PËRGJEGJËSITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori i shoqërisë është përgjegjës individualisht , ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkeljet e ligjeve, për shkeljet e statutit, apo përfajje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe

Egzon Berisha

Egzon Berisha

ortakut që ka lërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individual ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

2. Pervec sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14,15,17,e 18 të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar)

3. Administratori nuk mund të marrë hua nga shoqëria, te miratojë në emër të shoqërisë paradhëniet ose të bëhet garant për detyrimet ndaj personave të tretë. Në rast të kundërt veprimi është i pavlefshëm, kjo vlen edhe për përfaqësuesit e tij ligjorë, bashkëshortin si edhe paraardhësit apo pasëardhësit e tij.

4. Administratori ka detyrë që të paktën një herë në vit t'i paraqesë asamblesë raportin mbi aktivitetin e shoqërisë dhe gjëndjen e pasurisë së tij.

5. Administratori përgatit dhe i paraqet asamblesë raportin lidhur me marrëveshjen mes atij ose një ortaku dhe shoqërisë. Ortaku që është palë e marreveshjes nuk mund te votojë në mbledhjen e asamblesë. Administratori ose ortaku që nënshkruajnë një marrëveshje pa miratimin e asamblesë i përgjigjen shoqërisë për dëmin e shkaktuar si pasojë e kësaj marrëveshjeje.

6. Administratori, gjatë kryerjes se detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arësyeshme me qëllimet e shoqërise tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlefshimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.

NENI 23

USHTRIMI VJETOR , PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË


1. Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor. Në fund të vitit ushtrimor administratori procedon me hartimin e bilancit me llogaritjen e fitimit dhe humbjes sipas normave te ligjit, duke e shoqëruar me një relacion shtesë per aktivitetin e shoqërise.

NENI 24

NDARJA E FITIMIT

Pas plotësimi, të parashikimeve të nenit 77 të ligjit 9901 datë 18.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve ose caktaku të vetëm të saj, mund të deklarojë shpërndarjen e dividentëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, reduktuar me 5% te destinuar për rezervën ligjore, që arrin deri ne 10 % të kapitalit të shoqërisë, si edhe reduktimet eventuale të përcaktuara nga Asambleja, shpërndahen ndërmjet ortakëve në raport me kuotat e kapitalit që zotëron secili.



NENI 25

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHIJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund te dalin gjatë kohës së ushtrimit të veprimitarise së shoqërisë nga interpretimi, zbatimi dhe zgjidha e Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë si dhe në përgjithësi të gjitha mosmarrëveshjet e ortakëve, apo midis një ortaku dhe shoqërisë, në parim do të zgjidhen me mirëkuptim në bazë të aktit të Akt-themelimit dhe Statutit, në mungesë të mirëkuptimit zgjidha i besohet Gjykatës Shqipëtare korapetente në Rrethin Gjyqësor përkatës.

NENI 26

PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Shoqëria shpërbehet :

- Ditën e shënuar në regjistrin tregtar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.
- Ditën e shënuar në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për prishjen e shoqërise.
- Me hapjen e procedurave të falimentimit
- Në rastë të tjera të parashikuara në ligj.
- Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :
 - kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
 - me vendim të Asamblese se Ortakeve;
 - me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarise në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- me vendim të gjykatës;
- Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper ”.
- Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket
- Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 27

Egzon Berisha
Egzon

GJUHA

Ky statut dhe odo dokument tjetër zyrtar paraqiten në gjuhën shqipe.

NENI 28

BAZA LIGJORE

Përsa nuk është shprehur në këtë statut, është kompetencë e Asamblesë së Ortakëve ose Ortakut të vetëm, që të bëjë plotësinë e dispozitave të këtij statuti, si dhe shfuqizimin e atyre dispozitave të cilat bëhen të pavlefshme dhe jo efektive.

Ndryshimet do të bëhen me Vendim të Asamblesë Ortakëve, në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit shqipëtar, dhe depozitohen në QKB.

Ortak Themelues:

Egzon Berisha

